



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

Nr. 867. prot.

Tiranë, më 05.06.2024

LËNDA: THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI PËR EKSPERT VLERËSUES TË VLERAVE KULTURORE, TË PASURIVE TË PALUJAJTSHME

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Kreu II “Vlerësimi dhe deklarimi i interesit kulturor dhe regjistrimi pasurisë kulturore”, neni 59 të ligjit nr. 27/2018, datë 17.5.2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, Udhëzimit nr.665 datë 23.10.2023 “Për miratimin e kriterëve dhe pranimin në listën e ekspertëve vlerësues të vlerave kulturore të pasurive të luajtshme, të paluajtshme dhe jo-materiale”, Udhëzimit Nr. 666, datë 23.10.2023 “Për Mënyrën e funksionimit të Komisioneve Këshillimore për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe jo materiale” dhe Udhëzim Nr.273, datë 9.5.2024 “Për kriteret dhe mënyrat e depozitimit të kërkesave për verifikim të interesit kulturor, dokumentacioni shoqërues i aplikimit, kriteret për marrjen e vendimit dhe metodologjinë e tarifave”, fton të interesuarit për të shprehur interes për shpalljen në vijim:

EKSPERT VLERËSUES TË VLERAVE KULTURORE, TË PASURIVE TË PALUJAJTËSHME

Qëllimi i kësaj thirrje është përzgjedhja e ekspertëve vlerësues të fushës së trashëgimisë kulturore për identifikimin e vlerësimin e vlerave kulturore të pasurive kulturore të paluajtshme, në Komisionin e Vlerësimit të Objekteve të Trashëgimisë Kulturore.

I. PROCEDURA E APLIKIMIT:

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e aplikimit si më poshtë:

- 1) Shprehjen e interesit ku të pasqyrojë shkurtimisht përvojën / projektet e realizuara në të kaluarën (në 5-vitet e fundit) lidhur me fushën e kërkuar të ekspertizës si dhe kualifikimet përkatëse;
- 2) Jetëshkrimin e përditësuar;
- 3) Kopje të dokumentit të identifikimit;

- 4) Kopje të noterizuar diplomës, që vërteton përfundimin e ciklit të dytë të studimeve universitare për fushën përkatëse të ekspertizës, ose diplomë të njehsuar me të;
- 5) Kopje noterizuar të librezës së punës;
- 6) Vërtetim të shlyerjes së detyrimeve fiskale të lëshuar nga administrata tatimore në sistemin e-albania, për tre muajt e fundit;
- 7) Vërtetim që ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga administrata tatimore në sistemin e-albania, për tre muajt e fundit;
- 8) Fotokopje të noterizuar të kualifikimeve ose certifikatave që zotëron në fushën e ekspertizës së thirrjes;
- 9) Dy referenca nga një person akademikë ose punëdhënësi;
- 10) Vetë deklaram të gjendjes gjyqësore.

II. VENDNDODHJA DHE KOHËZGJATJA E DETYRËS

Data e fillimit: Data e parashikuar e fillimit është menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.

Kohëzgjatja e detyrës: 5-vjet

Vendndodhja e detyrës: Tiranë-Shqipëri

III. KRITERE PËR EKSPERTIN

Çdo kandidat duhet:

- 1) Të jetë shtetas shqiptar;
- 2) Të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor” apo “Master Profesional”, edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- 3) Të ketë përvojë pune në profesionin e ekspertizës së thirrjes të paktën 5-vite;
- 4) Të ketë përgatitje të lartë profesionale;
- 5) Të mos jetë i dënuar më parë për kryerjen e një veprë penale që lidhet me profesionin;
- 6) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (në fushat përkatëse).

IV. ARSIMI DHE KUALIFIKIMI

Arsimi dhe kualifikimi për aplikantët që kandidojnë për ekspert pranë **Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK)** duhet të plotësojë kriteret specifike të mëposhtme:

- 1) Të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor” apo “Master Profesional” në arkeologji, histori, arkitekturë, inxhinieri dhe/ose të zotërojë diplomë “Doktor i Shkencave” në fushat e mësipërme, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë ose të ketë diplomë ekuivalente, të njohur dhe të njësuar sipas legjislacionit në fuqi;
- 2) Të ketë licencë në arkeologji/projektim/zbatim/mbikëqyrje/kolaudim, në një ose disa nënkategori, në pasuri kulturore sipas legjislacionit në fuqi;

- 3) Të ketë të dokumentuar përmes publikimeve në revistat shkencore brenda ose jashtë vendit, veprimtaritë kërkimore shkencore lidhur me fushën e veprimtarisë për të cilën aplikon si ekspert (qe vërtetohen nëpërmjet linqeve);
- 4) Të ketë kualifikime në fushën dhe gjininë specifike të pasurisë kulturore për të cilin do të kryhet vlerësimi (fotokopje te tyre);
- 5) Të jetë fleksibel dhe tu përgjigjet nevojave të institucionit kontraktues.

V. PAGESA

Pagesa për këtë detyrë është sipas vendimin nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të Anëtarëve të Këshillave, Bordeve ose Komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore”, i ndryshuar.

Kandidatët e interesuar duhet t’i dorëzojnë dokumentet e aplikimit brenda datës 05.07.2024, ora 16:30, në adresën si në vijim:

Instituti i Trashëgimisë Kulturore, Rr. “Aleksandër Moisiu” Nr. 76, ish-Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë, Shqipëri,

me mbishkrimin në zarf:

Aplikim për: **EKSPERT VLERËSUES TË VLERAVE KULTURORE, TË PASURIVE TË PALUAJTËSHME**”.

Kandidatët që do të përzgjidhen Ekspertë Vlerësues do të kontaktohen për intervista.
Kandidatët që nuk kualifikohen për pranimin si Ekspertë Vlerësues, do njoftohen me shkrim.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

SOKOL ISMAILI